

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		09/09	2021
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-	060/01-	27393	

**PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)  
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)**

<b>Komuna / Opština: <u>Drenas</u>    Data / Datum: 29.06.2021</b>
<b>Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 3</b>
<b><u>Takim i rregullt</u> / Redovni sastanak <input checked="" type="checkbox"/>      Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak <input type="checkbox"/></b>
<b>Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>18</u></b>
<b>A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?</b>
Po / Da <input type="checkbox"/> Jo / Ne <input type="checkbox"/> Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice <input type="checkbox"/>
<b>A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?</b>
Po / Da <input type="checkbox"/> Jo / Ne <input checked="" type="checkbox"/> <i>Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju</i>
<b>A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?</b>
Po / Da <input checked="" type="checkbox"/> Jo / Ne <input type="checkbox"/>
<b>Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:</b>
Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës:
1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBB-së të mbajtur me 14.04.202- Linku: <a href="https://kk.rks-gov.net/.../sites/10/2021/04/Scan_357.pdf">https://kk.rks-gov.net/.../sites/10/2021/04/Scan_357.pdf</a>
2. Njoftim për situatën epidemiologjike dhe vaksinimin në masë;
3. Njoftim lidhur me mbarimin e vitit shkollor 2020/2021;
4. Njoftim lidhur me çështjen e ndriçimit publik dhe mirëmbajtjen e tij;
Ndërsa, janë shtuar edhe tri pika tjera të cilat janë diskutuar nga anëtarët e KKSBB-së:
4. Masat e ndërmarra për sigurimin e ujit të pijes gjatë sezonës verore;
5. Ndërmarrja e masave parandaluese për zjarrvëniet në natyrë;

6. Ndërmarrja e masave për sanimin e dëmeve të cilat po shkaktohen gjatë realizimit të projekteve nga operatorët.

*Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:*

*Tek të ndryshmet janë diskutuar tema që ndërlidhen me sigurinë e përgjithshme, si angazhimi i Policisë me tërë kapacitetet për sigurinë në trafik.*

#### **Konkluzionet / Zaključci:**

Procesverbali i mbledhjes së fundit të mbajtur me datën 14.04.2021 është miratuar pa ndonjë vërejtje. Për pikën e dytë, për njoftimin e situatës epidemiologjike në Komunën e Drenasit dhe procesin e vaksinimit ka informuar të pranishmit, drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Arsim Haxhiu. Haxhiu ka thënë se aktualisht është vetëm një rast aktiv me covid apo shprehur në përqindje 0,05%. Ndërsa sa i përket vaksinimit, ai ka thënë se janë gjithsej 4675 të vaksinuar dhe se procesi deri tani po shkon mirë.

Për pikën e tretë, drejtori i Arsimit, Muhamet Gjoka ka informuar anëtarët e KKSB-së për përmbylljen e vitit shkollor, të cilin pavarësisht pandemisë e ka vlerësuar të suksesshëm. Ai gjithashtu të pranishmit i ka informuar se Ministria e Arsimit gjatë ditës së djeshme ka njoftuar se dy profilet Infermiera dhe Mjekësia e Përgjithshme e Shkollës Profesionale "Fehmi Lladrovci" janë hequr nga planifikimi për regjistrim në vitin e ri shkollor 2021/2022, pa ndonjë sqarim apo njoftim paraprak, për të cilën menjëherë ka kërkuar sqarime apo arsyeje për këtë vendim.

Për pikën e katërt lidhur me ndriçimin publik, ka treguar për gjendjen drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapë. Ajo ka njoftuar të pranishmit me punën që është kryer deri tani për zgjerimin dhe shtrirjen e rrjetit të ndriçimit. Ndërsa, ka theksuar se disa fshatra me vetëiniciativë kanë bërë shtrirjen e rrjetit të ndriçimit. Pjesëmarrësit parashtruan pyetje lidhur me mirëmbajtjen e tyre e cështje të tjera që ndërlidhen me ndriçim, ku Drejtoresha Krapë është përgjigjur në adresimet e tyre.

Drejtoresha Krapë ka njoftuar edhe për gjendjen e ujit të pijes dhe masat parandaluese e zjarreve dhe i është përgjigjur pyetjeve të adresuara nga anëtarët e KKSB-së. Ajo ka treguar se për zjarret e uljet

që janë të përmasave më të mëdha, i dalin në ndihmë zjarrfikësit e komunave fqinje si Skenderaj, Lipjani etj. Po ashtu, ajo i njoftoi edhe për çantat shpinorë të cilat nevojiten për sigurinë dhe parandalimin e zjarrëvenieve.

Kurse për dëmet eventuale që mund të shkaktojnë kompanitë gjatë realizimit të projekteve, ato janë të obliguara që të bëjnë sanimin, përkatësisht kthimin në gjendjen e mëparshme. Pjesëmarrësit shprehën disa pakënaqësi lidhur me dëmet që po shkaktohen nga kompanitë gjatë implementimit të projekteve nëpër fshatra, ku nga Drejtoria e Infrastrukturës theksuan se për çdo dëmtim eventuale, kompania është e obliguar të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Në pikën të ndryshme, janë diskutuar çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm dhe sigurinë e qytetarëve të Komunës së Drenasit, si siguria në trafik dhe bashkëpunimi i qytetarëve me Policinë e Drenasit. Në këtë pikë, Komandantja e Stacionit Policor, Feime Bajrami njoftoi të pranishmit me angazhimin që është bërë këto ditë, dronët dhe rritjen e numrit të pjesëmarrësve në trafik në mënyrë që të parandalohen aksidentet.

**Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKS-së:**  
**Izveštaj përpiluesi Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi**  
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime / potpis)

**Procesverbali aprovohet nga Kryetari:**  
**Izveštaj odobrava Gradonačelnik: Ramiz Eladrovci**

Nënshkrimi / potpis

**Data e aprovimit / Datum odobranja: 09.07.2021**

**Rekomandimet:**

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKS-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: [mpb.dsb@rks-gov.net](mailto:mpb.dsb@rks-gov.net)
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: [Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net](mailto:Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net)

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me fjesën e takimit të ardhshëm të KKS-së.